



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 23.06.2022, e cila filloi në orën 16:15.

Në mbledhje morën pjesë: Arbër Vokrri -VV, Fiknete Bejta-LDK, Taulant Maxharraj-AAK, Mimoza Xhaka- Bllacaku-eksperte e jashtme.

Mungoi: Liridon Selmani -PDK.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Arton Brahim, përfaqësues nga Sektori për punë të Kuvendit. Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend dite :**

1. Propozimvendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Të ndryshme.

Kryesuesi fillmisht i përshëndeti të pranishmit, njisherit duke ju dëshiruar mirëseardhje në mbledhjen inauguruese të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Lidhur me këtë ai tha se, sot në rend të dite për këtë mbledhje është zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, prandaj nëse keni ndonjë propozim e hapi diskutimin.

**Mimoza Xhaka- Bllacaku** fillmisht anëtarëve të këtij komiteti ju uroj suksese dhe punë të mbarë dhe për kryesuese të komitetit propozoi znj. Fiknete Bejta.

**Taulant Maxharraj** tha se edhe unë pajtohem me propozimin që znj. Bejta të jetë kryesuese e komitetit.

**Arbër Vokrri** tha se edhe unë pajtohem që znj. Bejta të zgjedhet kryesuese e komitetit.

Kryesues i mbledhjes e hodhi në votim propozimin për znj. Bejta.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 4 vota për, znj. Fiknete Bejta zgjedhet kryesuese e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

**Pika e dytë**  
**Të ndryshme**

**Arbër Vokrri** tha se neve na duhet ndoshta me i përcaktuar objektivat tona se çka mundemi me propozuar gjatë këtij afati.

Si prioritet i këtij komiteti do duhej të ishin disa çështje të cilat ndërlidhen kryesisht me shëndetësisë, e që kjo temë është ngritur pothuajse nga të gjitha partitë politike gjatë fushatës së zgjedhjeve, pra është fjala për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm të Qytetit dhe mendoj që kjo duhet me qenë prej prioriteteve kryesore.

Gjithashtu duhet pasur parasysh një komunikim pak më të ngjeshur me punëtorët shëndetësorë, që me i shikuar se cilat janë nevojat e punëtorëve shëndetësorë për kujdesin e marr qysh funksionojnë si ndërrimet e ditës, ndërrimet e natës, etj.

Dihet se në Prishtinë në kujdesin primar marrin shërbim gati në mënyrë të njëjtë për nga numri si qytetarët e Prishtinës që paguajna taksat në Prishtinë, si qytetarët e komunave tjera që paguajnë taksat për komunat e veta edhe barra e kësaj kalohet kryesisht te punëtorët shëndetësorë dhe te buxheti i Komunës.

Planifikimi që behët për ndarje të buxhetit për shëndetësi bazohet në regjistrimin e popullsisë, ku mbi rreth 200 mijë banorë që janë të regjistruar si rezident në Prishtinë, të pa regjistruar po që jetojnë në Prishtinë janë se paku edhe një herë kaq. Do të ishte mirë që ndoshta me e ndërruar parimin, pra si do të behët ndarja e buxhetit prej shërbimeve në vend të numrit të banorëve dhe për këtë me ju bërë kërkesë institucioneve qendrore.

**Taulant Maxharraj** tha se do të ishte mirë që të dakordohemi edhe me kryesuesen e komitetit që për mbledhjen e radhës ti zgjedhim 3-5 pika dhe të diskutojmë për to.

**Fiknete Bejta** tha se më vjen mirë që në grup i kemi dy doktor dhe janë të respektueshëm që kanë përkushtim për qytetin, po besoj që na kemi me e plotësuar grupin edhe me anëtarë të tjera të fushave përkatëse, pasi që ky komitet i përfshinë dy drejtori.

Si komitet, besoj që do ta bëjmë një kalendar të punës për çdo muaj qysh më çfarë tema kemi me u marr dhe këtë do ta bëjmë në koordinim të plot me juve për muajin e ardhshëm. Për mbledhjen e radhës do ta ftojmë edhe drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë që të koordinohemi edhe me atë për pikat të cilat do ti kemi për diskutim, andaj mendoj me e pas një komitet ma ndryshe se viteve të kaluara, se këto komitete nuk kanë funksionuar, kanë qenë vetëm në letër dhe nuk kanë pasur asnje rezultat.

**Taulant Maxharraj** tha se do të ishte mirë që drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë së paku me na njoftuar për zhvillimet çdo muaj ose çdo dy muaj, mvarësishet si të jetë më e arsyeshme.

**Mimoza Xhaka- Bllacaku** tha se prej vitit 2003 deri në 2006, komitetet kanë qenë shumë funksionale, sidomos Komiteti për Shëndetësi, dhe krejt procedurat krejt materialet gjithmonë i kanë shqyrtuar dhe komiteti e ka dhenë opinionin e vet, mendimin e vet për gjithçka.

**Taulant Maxharaj** po ashtu tha se edhe kjo ish dashtë me qenë reciproke edhe ne me u marr pak edhe me drejtorin, pra që me e njoftuar për aktivitetet dhe qëllimet tona, duke e ditur sa është hendeku i problemeve këtu.

**Fiknete Bejta** tha se është më se e nevojshme që me u koordinuar me drejtorin, se ne e kemi pas edhe problemin me "Handikosin" dhe tani na ka ardhur mundësia me e trajtuar për mes buxhetit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësja  
Nikelinda Bujupi

Pen!



Faqe 3 nga 3